



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 6984 Prot

Tiranë, më 22.12. 2014

URDHËR

Nr. 855 datë 22.12. 2014

"Për përcaktimin e grupit të gjakut dhe faktorit Rhesus D"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pika 4, nenit 11 dhe 15 të ligjit nr. 9739, datë 21.05.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, me qëllim rritjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të ofruar në fushën e transfuzionit të gjakut,

URDHËROJ

1. Përcaktimi i grupit të gjakut në institucionet shëndetësore publike dhe jo publike të bëhet vetëm nga mjekë specialistë në fushën e transfuzionit të gjakut.
2. Grupi i gjakut për pacientë të shtruar në spital do të përcaktohet vetëm në strukturat e shërbimit të transfuzionit të gjakut, që janë: Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe bankat e gjakut në spitale.
3. Fletë kërkesa për gjak dhe komponentë të tij, plotësohen nga mjeku klinikist, bazuar në grupin e gjakut të përcaktuar nga specialistë të Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut.
4. Përcaktimi i grupit të gjakut të kryhet sipas metodës së aprovuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.
5. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Drejtoritë e Spitaleve Universitare, Drejtoritë e Spitaleve Rajonale, Drejtoritë e Spitaleve në rrethe, Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë, Drejtoritë e Shëndetit Publik, Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë dhe Institucionet Shëndetësore jo Publike për zbatimin e këtij urdhri.
6. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
7. Urdhri Nr.49, datë 9.02.2007 "Për përcaktimin e grupit të gjakut dhe faktorit rhesus për plotësim dokumentacioni" shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas datës 01.01.2015.

